

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE

Raporte Financiare, tremujore

Referuar Kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 të Bankës së Shqipërisë për “Kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga Bankat dhe degët e Bankave të Huaja”

Për periudhën e mbyllur më Dhjetor 2024

Përmbajtja

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bankën.....	3
1.1 Informacion i përgjithshëm mbi bankën.....	3
1.2 Informacion mbi aksionarët dhe strukturën organizative të Bankës	4
1.3 Informacion mbi aktivitetet kryesore të Bankës.....	5
2. Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, zërat jashtë bilancit dhe treguesit e rentabilitetit.....	5
2.1 Bilanci kontabël	5
2.2 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.....	7
2.3 Zërat jashtë bilancit.....	8
2.4 Treguesit e Rentabilitetit	8
3. Struktura e kapitalit regullator.....	8
4. Mjaftueshmëria e kapitalit	10
4.1 Rreziku i kredisë.....	10
4.2 Rreziku i tregut.....	10
4.3 Rreziku operacional	10
4.4 Totali i zërave të bilancit dhe jashtë bilancit të ndara sipas klasave të ekspozimit dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit.....	10
4.5 Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	11
5. Informacion i përgjithshëm cilësor për ekspozimin ndaj rreziqeve	11
6. Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm	13
6.1 Informacion i përgjithshëm mbi rrezikun e kredisë.....	13
7. Rreziku i kredisë dhe teknikat e zbutjes së rrezikut.....	17
7.1 Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standarde	17

8. Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm.....	18
9. Rreziku operacional	19
10. Rreziku i normës së interesit në librin e bankës.....	20
10.1 Informacion i përgjithshëm mbi rrezikun e normës së interesit	20
10.2 Raporti i IRRB.....	20
11. Rreziku i likuiditetit	21
11.1 Informacion i përgjithshëm mbi rrezikun e likuiditetit.....	21
11.2 Aktivët Likuide-Pasivët Afatshkurtra	22
Niveli i aktiveve likuide dhe pasiveve afat-shkurtra si edhe treguesit e likuiditetit ne Dhjetor 2024 jane si me poshte:.....	22
11.3 Aktivët dhe Pasivët sipas maturitetit	23
Aktivët dhe pasivët sipas maturitetit të mbetur në 31 Dhjetor 2024 paraqiten më poshtë:	23
12. Politikat e shpërblimit.....	24
13. Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë	24
Anëtarët ekzekutivë të Bankës, nuk kanë/përfitojnë asnjë trajtim të vecantë ndryshe nga punonjësit e tjerë të Bankës.	24
14. Politikat kontabël	24
14.1. Bazat e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.....	24
14.2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël	24

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bankën


1.1 Informacion i përgjithshëm mbi bankën

Banka Amerikane e Investimeve sh.a. ("Banka" e njohur më parë si Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a.), është një filial i zotëruar tërësisht nga Tranzit sh.p.k. (i zotëruar më tej nga Andi Ballta dhe fonde investimi të menaxhuara nga NCH Capital Inc), një institucion financiar jo-bankar shqiptar i cili ofron mundësi financimi për shoqëritë dhe individët. Kjo blerje e cila u finalizua në fund të vitit 2015 është një histori suksesi në tregun bankar në Shqipëri, i cili historikisht ka patur eksperiencë sporadike të aktivitetit Blerje dhe Përthithje. Kjo shënoi herën e parë kur një bankë në krizë u ble dhe ndryshoi krejtësisht, ashtu sikurse ishte hera e parë kur një kompani me kapital privat u përfshi në sektorin bankar.

Brenda një periudhe të shkurtër Banka ktheu nga humbjet e thella historike në përfitueshmëri, një bilanc të pastër, mjaftueshmëri të fortë të kapitalit dhe rritje. Ndryshimi i kulturës dhe qëndrimi me fokus klientin përforcuan rezultatet pozitive të bankës.

Gjatë 2018, Banka Amerikane e Investimeve bleu nga Banka Kombëtare e Greqisë, (e cila në linjë me planet e saj të ristikurimit kishte vendosur të tërhiqej nga disa tregje jo-thelbësore duke përfshirë Shqipërinë) Filalin e saj në Shqipëri – Bankën NBG Albania SHA, që renditej e teta në treg me 300 mio EUR total asete, afërsisht në të njëjtën madhësi si ABI Bank. Pasi mori të gjitha aprovimet e nevojshme nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Banka e Shqipërisë ABI Bank realizoi në Tetor 2018 bashkimin me përthithje me Bankën e blerë duke u bërë Banka e gjashtë më e madhe në vend.

1.2 Informacion mbi aksionarët dhe strukturën organizative të Bankës



1.3 Informacion mbi aktivitetet kryesore të Bankës

Banka operon në përputhje me Ligjin Nr. 9662 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" të datës 18 Dhjetor 2006. Banka është e licencuar për të kryer aktivitetet e kreditimit dhe depozitimit, shërbimet e pagesave në Shqipëri dhe jashtë saj si dhe aktivitetet e tjera bankare në përputhje me ligjet Shqiptare.

2. Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, zërat jashtë bilancit dhe treguesit e rentabilitetit

2.1 Bilanci kontabël

Bazuar në të dhënat e muajit Dhjetor 2024, më poshtë paraqiten të detajuara pasqyrat e aktivitetit dhe pasivit.

Zërat kryesore të aktiveve janë:	Zërat kryesore të pasiveve janë:
1. Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare	1. Veprime me thesarin dhe transaksione ndërbankare
2. Veprime me klientët	2. Veprime me klientët
3. Veprime me letra me vlerë	3. Veprime me letra me vlerë
4. Mjete të tjera	4. Mjete të tjera
5. Mjete të qëndrueshme	5. Mjete të qëndrueshme dhe Kapitali Aksioner

Pasqyra e raportit financiar për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023.

AKTIVET (në mijë lekë)	31.12.2024	31.12.2023
VEPRIMET ME THESARIN DHE TRANSAKSIONET NDËRBANKARE	14,709,200	17,298,257
Arka dhe Banka Qendrore	11,351,471	12,939,677
Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për refinancim me Bankën Qendrore	3,862	3,423,423
Llogari rrjedhëse në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	2,961,190	623,389
Depozita me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare	392,677	311,768
VEPRIMET ME KLIENTËT	59,694,080	47,179,043
Hua standarde dhe paradhënie për klientët	56,936,716	43,439,580
Hua dhe paradhënie të papaguara në afat për klientët	1,580,753	2,574,105
Hua dhe paradhënie në ndjekje	642,093	821,654
Hua nënstandarde	530,491	285,836
Hua të dyshimta	216,091	216,017
Hua të humbura	73,017	22,628
Detyrimet ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	-	-
Llogari të tjera të klientëve	-	-
Llogari për t'u arkëtuar të klientëve përveç huave	7,215	36,459
minus fonde rezerve per huate	(292,295)	(217,236)
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	60,278,273	60,935,936
Letra me vlerë me të ardhura fikse	60,278,273	60,935,936

Letra me vlerë të vendosjes	22,781,539	23,004,277
Letra me vlerë të investimit	36,785,479	36,209,616
MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	1,379,636	1,747,387
Mjete të tjera	3,837,855	3,983,935
minus fonde rezerve per mjete te tjera	(2,527,278)	(2,261,353)
Llogari pezull dhe të pozicionit	69,059	24,805
MJETET E QËNDRUESHME DHE BURIMET E PËRHERSHME	1,242,837	1,566,864
Filiale	120,500	120,500
Mjete të qëndrueshme	3,498,063	3,953,336
Amortizimi I mjeteve te qendrueshme	(2,375,726)	(2,506,972)
TOTALI	137,304,027	128,727,488

PASIVET (në mijë lekë)	31.12.2024	31.12.2023
VEPRIMET E THESARIT DHE TRANSAKSIONET NDËRBANKARE	22,401,235	27,542,856
Banka Qendrore	-	-
Bono thesari dhe bono të tjera të përshtatshme për refinancim me Bankën Qendrore	21,803,321	26,684,818
Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	597,914	858,038
VEPRIMET ME KLIENTËT	100,510,426	87,677,011
Detyrime ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	100,510,426	87,677,011
Llogari rrjedhëse	19,841,707	17,707,143
Llogari depozitash pa afat	14,037,508	14,665,309
Llogari depozitash me afat	66,608,842	55,284,254
Llogari garancie	22,369	20,305
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	-	-
Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	-	-
MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	2,525,612	2,128,791
Detyrime të tjera	2,250,430	1,895,907
Transaksionet si agjente	60,948	98,360
Llogaritë pezull dhe të pozicionit	212,167	133,731
Tatimi i vlerës së shtuar	2,067	793
MJETE TË QËNDRUESHME DHE BURIME TË PËRHERSHME	11,866,753	11,378,830
Ndihma dhe financimi publik	-	-
Fondet rezervë specifike	738,757	611,679
Borxhi i varur	1,706,974	1,766,639
Kapitali i aksionerëve	9,421,022	9,000,511
Kapitali i paguar*	3,450,935	3,450,935
Primet e aksioneve	-	-
Rezerva	2,865,209	2,859,019
Diferenca e rivlerësimit	(865,185)	(870,155)

Fitimi (humbja) i pashpërndarë	911,640	911,640
Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor	3,058,423	2,649,073
TOTALI	137,304,027	128,727,488

2.2 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Zërat kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve janë:

1. Të ardhurat / Shpenzimet nga aktivitetet kryesore të bankës
2. Të ardhurat / Shpenzimet nga veprimtaria operacionale
3. Të ardhurat / Shpenzimet për fondet rezervë
4. Të ardhurat / Shpenzimet të jashtëzakonshme

LLOGARIA FITIM E HUMBJE (në mijë lekë)	31.12.2024	31.12.2023
	(në mijë lekë)	(në mijë lekë)
Shpenzime të veprimtarisë bankare	3,321,892	2,070,972
Shpenzime për interesa	2,080,248	1,657,188
Humbje nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimet financiare	315,713	334,185
Komisione	147,235	79,600
Shpenzime të tjera të veprimtarisë bankare	17	-
Humbje nga veprimet me valutat	778,679	-
Shpenzime për personelin	1,210,883	972,221
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	15,616	8,162
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	1,076,969	841,499
Amortizimi dhe fondet rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	175,789	178,962
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme shpenzime për fonde rezervë	1,256,296	2,407,077
Shpenzime të jashtëzakonshme	-	-
Taksa mbi të ardhurat	578,076	439,452
Fitimi i vitit në vazhdim	3,058,423	2,649,073
TOTALI I SHPENZIMEVE	10,693,943	9,567,418
Të ardhura të veprimtarisë bankare	9,792,060	7,599,818
Të ardhura nga interesat	4,309,249	3,212,216
Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimtaritë e tjera financiare	3,305,643	3,667,099
Komisione për shërbime bankare	756,745	507,276
Të ardhura nga veprimet e qirasë	19,183	8,435
Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare	436,334	41,601
Fitime nga veprimet me valutat	964,906	163,192
Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e llogarive për t'u arkëtuar	901,883	1,967,600
Të ardhura të jashtëzakonshme	-	-
Humbja e vitit në vazhdim	-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE	10,693,943	9,567,418

2.3 Zërat jashtë bilancit

Zërat kryesore jashtë bilancit janë:

1. Angazhimet Financiare përfaqësuar nga pjesët e papërdorura të limiteve të huave dhe paradhëniet të dhëna klientëve.
2. Garancitë përfaqësuar nga kolaterat e klienteve, Letër-Garancitë dhe Letër-Kreditë
3. Transaksionet në valutë

Zërat e paraqitur nuk kanë patur lëvizje materiale nga periudhat e mëparshme:

ZËRAT JASHTË BILANCIT (në mijë lekë)	31.12.2024
ANGAZHIME FINANCIMI	4,397,859
GARANCITË	141,994,872
TRANSAKSIONE NË VALUTË	24,519
TOTALI	146,417,249

2.4 Treguesit e Rentabilitetit

Më poshtë jepen treguesit kryesor të rentabilitetit sikurse përcaktohen në kërkesat e rregullores nr. 60, "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja":

Treguesit e Rentabilitetit Dhjetor- 2024	
Te ardhurat neto/aktivet mesatare*100/ ROA	2.3%
Rezultati neto i jashtezakonshëm/aktivet mesatare	0.0%
Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë/te ardhurat bruto të veprimtarisë	25.3%
Te ardhurat neto nga interesat/shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë	210.5%
Te ardhurat neto/kapitali aksionar mesatar*100/ ROAE	39.8%
Totali i aktiveve/Numri i punonjësve	314,917
Te ardhurat neto nga interesat/aktivet mesatare	3.9%
Shpenzimet për interesat/aktivet mesatare	1.8%
Te ardhurat neto nga interesat/te ardhurat bruto të veprimtarisë	53.3%
Te ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera/aktivet mesatare	1.5%
Shpenzimet jo për interesat/te ardhurat bruto të veprimtarisë	1.5%
Shpenzime personeli/te ardhurat bruto të veprimtarisë	12.4%
Shpenzimet për provigjone/aktivet mesatare	0.3%

3. Struktura e kapitalit rregullator

Kapitali rregullator është kapitali që shërben për mbulimin e rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional. Kapitali rregullator është llogaritur në zbatim të rregullores nr 69 për "Kapitalin rregullator" dhe përbëhet nga:

- a) Kapitali i nivelit të parë
- b) Kapitali i nivelit të dytë

a) Kapitali i nivelit të parë llogaritet si shumë e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë duke marrë në konsideratë zbritjet sipas kërkesave rregullatore. Konkretisht në strukturën e kapitalit të ABI Bank përfshihen zërat si me poshtë:

- Kapitali i paguar
- Fitimet e pashpërndara
Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)
- Diferenca rivlerësimi kreditore

b) Kapitali i nivelit të dytë përbëhet nga: i) instrumentet e kapitalit dhe borxhi i varur që plotësojnë

KAPITALI RREGULLATOR		31.12.2024
Zëri		Shuma (në mijë lekë)
KAPITALI RREGULLATOR		10,758,938
KAPITAL I NIVELIT TË PARË		9,297,389
KAPITAL BAZË I NIVELIT TË PARË		9,297,389
Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)		3,450,935
Kapitali i paguar		3,450,935
Primet e aksioneve		0
(-) Instrumenta të veta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë		0
(-) Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në instrumentat e Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë		0
Fitimet e pashpërndara		3,970,063
Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme		0
Fitimi ushtrimor i fundit të vitit		911,640
Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese		3,058,423
Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)		2,865,209
Diferenca rivlerësimi kreditore		(865,185)
Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë		0
(-) Aktive të tjera të patrupëzuara		(123,633)
(-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara		123,633
KAPITALI SHITESË I NIVELIT TË PARË		0
KAPITALI I NIVELIT TË DYTË		1,461,548
Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si kapital i nivelit të dytë		1,461,548

Kushtet për t'u përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë (dhe që nuk janë përfshirë në kapitalin e nivelit të parë) dhe nga ii) primet e emetimit të lidhura me instrumentet e përcaktuara në shkronjën "a" të këtij paragrafi. Minimumi i kërkuar për normën e kapitalit bazë të nivelit të parë është 4.5% ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezik, për normën e kapitalit të nivelit të parë është 6% e ekspozimeve të ponderuara me rrezik dhe për normën e kapitalit rregullator është 12% e ekspozimeve të ponderuara me rrezik.

4. Mjaftueshmëria e kapitalit

4.1 Rreziku i kredisë

Bazuar në rregulloren nr. 48, neni 10, Bankat klasifikojnë çdo ekspozim të zërave, brenda dhe jashtë bilancit, në një nga klasat e ekspozimit në vijim:

- Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;
- Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;
- Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);
- Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;
- Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;
- Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;
- Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);
- Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve të klientëve individë (retail);
- Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;
- Ekspozime (kredi) me probleme;
- Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;
- Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;
- Ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (securitization);
- Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK; dhe/ose
- Zëra të tjerë

4.2 Rreziku i tregut

Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut, llogaritet sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuara me 12.5.

Banka llogarit kërkesën për kapital për rrezikun e tregut si shumë e kërkesës për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit, si i vetmi indikator i rrezikut të tregut në Bank.

4.3 Rreziku operacional

Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun operacional sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient α prej 15%.

4.4 Totali i zërave të bilancit dhe jashtë bilancit të ndara sipas klasave të ekspozimit dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit sikurse në 31 Dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë dhe të dhënat janë në mijë Lekë:

KAPITALI RREGULLATOR	10,758,938
RMK (%)	18.15%
SHUMA TOTALE E EKSPOZIMEVE TE PONDERUARA ME RREZIK	59,266,918
RREZIKU I KREDISE	
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)	49,897,771.81
Klasat e ekspozimit sipas SA duke përjashtuar pozicionet e titullzimit	49,897,771.81
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	2,069,895
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	257,125
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	27,316,975
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	2,736,491
Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	12,358,048
Ekspozime (kredi) me probleme;	617,673
Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	1,581,272
Zëra të tjerë	1,971,513
Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura dhe shoqërive tregtare me një vlerësim afatshkurtër të kredisë	687,530
Ekspozime të kapitalit	301,250
RREZIQUET E TREGUT	
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	-
Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	-
Rreziku i kursit të këmbimit	-
Rreziku i investimeve në mallra	-
RREZIKU OPERACIONAL	-
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	9,369,146
Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	9,369,146

4.5 Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Në Dhjetor 2024 Banka raporton një normë mjaftueshmërie **18.15%** duke përfshirë kapitalin e nivelit të dytë dhe një normë të mjaftueshme për kapitalin e nivelit të parë prej **15.69%**.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	Shuma
(në mijë lekë)	
1. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	18.15%
2. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit baze te nivelit te pare	15.69%
3. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit te nivelit te pare	15.69%

5. Informacion i përgjithshëm cilësor për ekspozimin ndaj rreziqeve

Si pasojë e përdorimit të instrumenteve financiare, Banka ekspozohet kryesisht ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë/kundërpartisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Banka konsiderohet si një Bankë Retail që ofron për klientët e vet produkte & shërbime tradicionale në fushat e mëposhtme të biznesit:

- Banking Retail dhe kredi konsumatore;
- Banking Komercial (tregëti ndërkombëtare, kredi për kompanitë e mesme dhe të mëdha);
- Pagesat (transfertat e parave brenda dhe jashtë bankës);
- Broker dhe shitje të produkteve financiare (këmbime, tregtime në tregjet financiare, norma interesi, etj);
- Faktoring;
- Shërbime ndërmjetëse për ankandet kryesore, brokerim, kujdestari e letrave me vlerë dhe shërbime depozitare për Investime & fonde Pensioni;
- Shërbimi i ruajtjes (Safekeeping services);
- Broker i produkteve të sigurimeve (të lidhura me produktet e kredisë);
-

Banka operon brenda territorit të Shqipërisë duke ju shërbyer klientëve në zonat më të populluara të vendit me prezencën e saj me rrjetin e Degëve **(27 Degë)**.

Banka harton dhe rishikon në mënyrë periodike Strategjinë e menaxhimit të risqeve, zhvillon dhe mirëmban sistemin e matjes dhe monitorimit të tyre. Sistemet e riskut, përfshijnë por nuk limitohen në vendosjen dhe monitorimin e standardeve dhe kufijve maksimalë për ekspozime në risqe specifike si më lart, si dhe adaptimet e tyre në bazë të zhvillimeve periodike të kushteve të tregut, produkteve dhe shërbimeve të ofruara, raportet periodike të *stress testeve*, përmirësimet e të gjithë kuadrit rregullativ (politikat & procedurat e brendshme) të menaxhimit të risqeve dhe monitorimi i aplikimit korrekt të tyre nga stafi.

Banka, përmes standardeve dhe procedurave të trajnimit dhe të menaxhimit synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe të strukturuar, ku të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësi për vendosjen dhe për mbikëqyrjen në nivel të lartë të kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka krijuar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO), Komitetin e Rrezikut të Kredisë dhe Komiteti i Çështjeve Sensitive dhe Provizionimit (SAPC) të cilat kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të riskut të Bankës në fushat e tyre specifike. Të gjithë komitetet e Bordit kanë anëtarë ekzekutivë dhe jo ekzekutivë dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut & Kontrollit të Vazhdueshëm është njësia e specializuar që ka Banka që implementon në praktikë tërësinë e sistemeve, standardeve, dhe rregulloreve të menaxhimit të riskut në bashkëpunim të ngushtë me njësitë që e marrin atë përsipër në bazë ditore. Drejtori i këtij Divizioni ka direkt varësi funksionale & hierarkike nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës.

Komiteti i Kontrollit të Bankës ka përgjegjësi për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e menaxhimit të riskut të Bankës dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së kuadrit të menaxhimit të rreziqeve të hasura nga Banka. Komiteti i Kontrollit të Bankës asistohet në këto funksione nga Kontrolli i Brendshëm. Kontrolli i Brendshëm kryen rishikime të rregullta dhe të posaçme të kontrollit dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut, rezultatet e të cilave i raportohen Komitetit të Auditit.

6. Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm

6.1 Informacion i përgjithshëm mbi rrezikun e kredisë

Rreziku i kredisë / kundërpartisë është rreziku më dominant që ka Banka në portofolin e aseteve të saj. Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, nga investimet në letra me vlerë dhe në zëra të tjerë jashtë bilancit. Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës në rast se huamarrësi ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk përmbush detyrimet e tij kontraktuale.

Banka ka një vendimarrje të centralizuar të kredisë në një nivel të lartë që është Komiteti i Kredisë, i deleguar nga Bordi i Drejtorëve, si dhe një Komitet të specializuar i lidhur me menaxhimin e portofolit me probleme dhe provigjioneve. Politika e provigjionimit është totalisht e bazuar në Rregulloren Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë për Adminisitrimin e Rrezikut të Kredisë. Në bazë të saj bëhet vlerësimi dhe ndarja e portofolit në 5 kategori risku të bazuara në:

- ditët në vonesë si dhe në kritere të tjera cilësore të cilat keqësojnë situatën financiare dhe ligjore të klientit;
- statusi i implementimit të një skeme ristrukturimi (periudha prove ose pas saj);

Kategoritë dhe normat e provigjioneve të aplikueshme janë:

- | | |
|------------------|----------|
| - Standarde: | min 1% |
| - Në Ndjekje: | min 5% |
| - Nën-Standarde: | min 20% |
| - E Dyshimtë: | min 50% |
| - E Humbur: | min 100% |

Kreditë me probleme janë të gjitha ato kredi që janë kategorizuar në një nga klasat Nënstandarde, të Dyshimta dhe të Humbura.

Banka aplikon Politika të mirëfillta për Menaxhimin e Rrezikut të Kredisë për cdo segment të portofolit të saj si psh: për Individët, Bizneset e vogla, të mesme dhe ato të mëdha. Këto politika dokumentojnë principet bazë, definicionet, standardet dhe rregullat e riskut të kredisë për ta identifikuar, vlerësuar, aprovuar, monitoruar dhe raportuar atë. Këto politika përfaqësojnë kriteret minimale të kërkuara për aplikim. Ato gjithsesi nuk zëvendësojnë eksperiencën njerëzore, gjykimin e drejtë dhe logjik.

Portofoli i kredive dhe kreditë me probleme sipas shpërndarjes gjeografike në 31 Dhjetor 2024 është si më poshtë dhe të dhënat janë në mijë Lekë:

Klasifikimi i portofolit të kredive dhe kreditë me probleme sipas shpërndarjes gjeografike

në '000 lek

Rrethi	Në total	Kredi me probleme
Rrethi Tiranë	45,283,998	674,794
Rrethi Durrës	5,790,543	21,687
Rrethi Elbasan	259,550	74,612
Rrethi Shkodër	245,786	668
Rrethi Korçë	59,860	2,774
Rrethi Vlorë	2,134,745	11,203
Rrethi Lushnje	200,980	2,137
Rrethi Gjirokastrë	39,517	285
Rrethi Fier	701,041	14,655
Rrethi Sarandë	769,178	2,917
Rrethi Kavajë	3,779,945	3,543
Rrethi Lezhë	460,865	13,626
Rrethi Berat	196,152	115
Rrethi Pogradec	41,974	1,615
Rrethi Kukës	21,406	2,103
Rrethi Bilisht	836	79
TOTALI	59,986,375	826,813

Evidenca e kreditit dhe kreditë me probleme sipas degëve të ekonomisë në **31 Dhjetor 2024** është si më poshtë dhe të dhënat janë në mijë Lekë

Klasifikimi i portofolit të kredive dhe kreditë me probleme sipas degëve të

në '000 lek

Kodi i Industrisë	Në total	Kredi me probleme
Bizneset	50,226,429	493,801
Shërbime	15,624,396	9,172
Tregtia	6,132,629	79,501
Ndërtimi	14,459,258	-
Prodhimi	4,501,702	66,547
Pasuritë e patundshme	3,447,761	-
Të tjera	6,060,681	338,580
Individët	9,759,946	333,013
Total	59,986,375	826,813

Portofoli total i kredive bruto sipas maturitetit në **31 Dhjetor 2024** është si më poshtë:

Teprica Bruto e Kredise sipas shportave te maturitetit	
Maturiteti	Shuma në '000 lek
1 - 7 dite	1,100
< 1 muaj	1,172,253
1 deri 3 muaj	8,249,273
3 deri 6 muaj	2,307,828
6 deri 12 muaj	6,807,223
1 deri 5 vjet	17,391,701
>5 vjet	24,056,998
Totali	59,986,375

Kreditë që u ka kaluar afati sipas degëve të ekonomisë dhe shpërndarjes gjeografike në **31 Dhjetor 2024** janë si më poshtë:

Klasifikimi i portofolit të kredive që u ka kaluar afati sipas shpërndarjes gjeografike	
ne '000 lek	
Rrethi	Shuma
Rrethi Tiranë	3,702,816
Rrethi Durrës	285,985
Rrethi Elbasan	75,380
Rrethi Shkodër	20,550
Rrethi Korçë	8,804
Rrethi Vlorë	20,225
Rrethi Lushnje	131,955
Rrethi Gjirokastrë	2,308
Rrethi Fier	11,897
Rrethi Sarandë	3,640
Rrethi Kavajë	46,756
Rrethi Lezhë	53,995
Rrethi Berat	45,055
Rrethi Pogradec	3,658
Rrethi Kukës	4,913
Rrethi Bilishti	66
TOTALI	4,418,004

Klasifikimi i portofolit të kredive që u ka kaluar afati sipas degëve të ekonomisë

në '000 lek

Kodi i Industrisë	Shuma
Bizneset	3,915,604
Bujqësia, peshkimi , gjuetia dhe silvikultura	3,419
Industria nxjerrëse	6,058
Industria përpunuese	213,073
Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit	2,180,212
Ndërtimi	57,155
Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiak	393,525
Hotelet dhe restorantet	162,749
Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni	1,643
Ndërmjetësim monetar dhe financiar	110,141
Pasuritë e patundshme, dhënia me qira etj.	673,344
Administrimi publik	-
Arsimi	40,159
Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	74,125
Shërbime kolektive, sociale dhe individuale	-
Të tjera	-
Individët	502,400
Total	4,418,004

Lëvizjet në fondet rezervë sipas kategorive të krijuara nga Banka për tremujorin **e katert të vitit 2024** në mijë Lekë janë si më poshtë:

FONDET REZERVË TË KRIJUARA NGA BANKA	Teprica në fillim	Shtimi i provigjoneve	Rimarrje e provigjoneve	Kreditë e fshira gjatë periudhës	Korigjime të tjera Korigjime të tjera	Teprica në fund
FR për mbulimin e humbjeve nga huatë nënstandarde	122,034	-	3,276	-	-	118,759
FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e dyshimta	93,275	32,041	-	-	-	125,316
FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e humbura	57,207	6,228	-	-	-	63,436
FR për llogaritë për t'u arkëtuar të klientëve në status të dyshimtë përveç huave	473	132	-	-	-	605
FR për të mbuluar zhvlerësimin	286,553	-	241,266	-	-	45,287
FR për zhvlerësimin e mjeteve të tjera	2,308,911	30,081	-	-	-	2,338,992
FR për rreziqe e shpenzime	752,141	-	798	-	-	751,343
FR specifike të tjera	-	-	-	-	-	-
Totali	3,620,594	68,483	245,339	-	-	3,443,737

7. Rreziku i kredisë dhe teknikat e zbutjes së rrezikut

7.1 Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standarde

Informacion përmblendhës për secilën klasë të ekspozimit

Banka llogarit kërkesën për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, sipas Metodës Standarde.

Kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, sipas metodës standarde, është e barabartë me 12% të totalit të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me peshat e rrezikut.

Vlera e ekspozimit është vlera e tij në bilanc, ndërsa vlera e ekspozimit të mundshëm, siç përcaktohet në rregulloren për Mjaftueshmërinë e Kapitalit, do të jetë një përqindje e vlerës së tij, sipas klasifikimit në kategoritë e rrezikut, si më poshtë:

- 100% e vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të lartë;
- 50% të vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të mesëm;
- 20% të vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të ulët;
- 0% të vlerës së tij, për kategorinë pa rrezik.

Banka llogari vlerën e ekspozimit përkatës, pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve

8. Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm

8.1 Informacion i përgjithshëm

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, nivelet e kredisë (jo të lidhura me ndryshime të gjëndjes së debitorit/memetuesit) do të ndikojnë fitimet e Bankës ose vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin mbi riskun.

Risku i kursit të këmbimit përkufizohet si mundësia që luhatjet e kurseve të këmbimit të krijojnë ndryshime të konsiderueshme, pozitive ose negative në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Burimet më të rëndësishme të riskut të normës së këmbimit konsistojnë në:

- Huadhëniet në monedhë të huaj dhe depozitat në monedhë të huaj të korporatave dhe individëve;
- Investime në letrat me vlerë;
- Tregtimi i kartëmonedhave të huaja;
- Arkëtimi ose pagesa e interesit, komisioneve, kostove administrative, etj. në monedha të huaja.

Banka, në rastet kur pozicioni total neto i hapur valutor i saj, i përcaktuar në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”, është më i lartë se 2% e kapitalit rregullator, shumëzojnë me 8% vlerën e këtij pozicioni, për llogaritjen e kërkesës për kapital rregullator për rrezikun e kursit të këmbimit.

9. Rreziku operacional

9.1 Informacion i përgjithshëm

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së Bankës si rezultat i proceseve të brendshme të papërshtatshme ose të keqpërdorura, dështimit të proceseve të brendshme; gabimeve njerëzore dhe të sistemeve; ngjarjeve të jashtme ose risku ligjor. Banka ka hartuar një kuadër të brendshëm rregullativ i cili mundëson matjen, vlerësimin dhe monitorimin e këtij rreziku nëpërmjet instrumentave si më poshtë:

- Baza e të dhënave e raportimeve të brendshme;
- Risk mapping (harta e rreziqeve);
- Paralajmërimet e rreziqeve operacionale;
- KRI (Indikatore të Riskut)

Monitorimi i Rrezikut Operacional sipas instrumentave të lartpërmendura shtjellohet në raporte mujore, tremujore dhe vjetore të cilat adresohen në mbledhjet e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm.

Banka llogarit kërkesën për kapital për rrezikun operacional, sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient prej 15%.

10. Rreziku i normës së interesit në librin e bankës

10.1 Informacion i përgjithshëm mbi rrezikun e normës së interesit

Banka mat rrezikun e normave të interesit, bazuar në udhëzimin “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës” date 30.04.2013, nëpërmjet metodës së vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës duke supozuar një goditje (shock) prej +200 pikësh bazë në kurbën referencë të kthimit.

Sipas kësaj metode Banka shpërndan vlerat aktuale të të gjitha pozicioneve të ndjeshme ndaj normës së interesit në 14 intervale kohore. Pozicionet me normë interesi fikse shpërndahen në intervale kohore sipas maturitetit të mbetur, ndërsa ato me normë interesi të ndryshueshme sipas kohës deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit. Pozicioni neto për çdo interval kohor shumëzohet me peshat përkatëse, të cilat llogariten si prodhim i goditjes (shock)-ut të normës së interesit +200 pikësh bazë me kohëzgjatjen e modifikuar për çdo interval kohor. Këto përlllogaritje behën për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për monedhat e tjera mbi baza të agreguara. Pozicioni total neto i ponderuar nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 20% të kapitalit rregullator të Bankës.

10.2 Raporti i IRRB

Forma totale e IRRBB-s		Totali i pozicioneve të ponderuara	Emri i Bankës / institucionit të kredisë: Banka Amerikane e Investimeve	
IRR			Monedha	Shuma
			1	2
1.1.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha LEKË		LEKË	1,797,372
1.2.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha EUR		EUR	(581,635)
1.3.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha USD		USD	(15,880)
1.4.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha të tjera		GBP	-
1.5.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha të tjera		Të tjera	(131)
2.	NDRYSHIMI NE VLEREN E EKSPOZIMIT		1,231,486	
3.	KAPITALI RREGULLATOR (oën funds)		10,758,938	
4.	(NDRYSHIMI NE VLEREN E EKSPOZIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100		11.45%	

11. Rreziku i likuiditetit

11.1 Informacion i përgjithshëm mbi rrezikun e likuiditetit

Risku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të përmbushur detyrimet që ka për shkak të pamjaftueshmërisë së likuiditetit ose pamundësisë për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (risku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit në aktive financiare pa ndikuar negativisht dhe në mënyrë të rëndësishme çmimet, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

Banka Amerikane e Investimeve menaxhon likuiditetin në përputhje të plotë me kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë dhe duke iu referuar praktikave më të mira në treg, duke synuar të sigurojnë një menaxhim efektiv të likuiditetit dhe një profil të sigurtë për riskun e likuiditetit. Banka sigurohet:

- Te jete gjithmone dhe në mënyrë të kënaqshme në gjendje për të financuar rritjen e aktiveve të saj;
- Te jete gjithmone dhe në mënyrë të kënaqshme në gjendje të përmbushë detyrimet e saj;

11.2 Aktivët Likuide-Pasivët Afatshkurtra

Niveli i aktiveve likuide dhe pasiveve afat-shkurtra si edhe treguesit e likuiditetit në Dhjetor 2024 janë si më poshtë:

AKTIVET LIKUIDE - PASIVET AFATSHKURTRA						
Kodi		LEKË	USD	EUR	TË TJERA	TOTALI
	(në mijë lekë)					
A	TOTALI I AKTIVEVE LIKUIDE	20,348,989	1,970,286	12,091,797	150,297	34,561,369
B	TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA ME AFAT TË MBETUR MATURIMI DERI NË 1 VIT	23,199,295	3,058,761	25,534,986	150,094	51,943,136
C	TREGUESI I LIKUJDITETIT (në %)					
1	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhen kombetare LEKË)					87.71%
2	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhat e huaja)					49.44%
3	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (ne total)					66.54%

11.3 Aktivët dhe Pasivët sipas maturitetit

Aktivët dhe pasivët sipas maturitetit të mbetur në 31 Dhjetor 2024 paraqiten më poshtë:

Kodi	AKTIVET SIPAS MATURIMIT TË MBETUR	DITE	MUAJ				VITE		TOTALI
	(në mijë lekë)	Deri 7	7 dite - 1	1 - 3	3 - 6	6 - 12	1 - 5	> 5	
1	VEPRIME ME THESARIN DHE NDËRBANKARE	8,298,981	1,508,710	344,426	515,146	1,030,291	3,011,646	-	14,709,200
2	VEPRIMET ME KLIENTËT	815,039	1,669,311	8,784,608	3,535,743	9,146,648	23,818,440	12,216,585	59,986,375
3	TRANSAKSIONE TË LETRAVE ME VLERË	18,166	7,365,907	5,083,471	715,548	2,597,810	31,766,058	12,818,813	60,365,775
4	MJETE TË TJERA	2,038	97,739	17,732	5,550	668,732	2,978,661	1,379,299	5,149,751
	Totali i aktivitet	9,134,225	10,641,668	14,230,237	4,771,988	13,443,482	61,574,805	26,414,697	140,211,101
	Totali i zerave jashte bilancit	75,112	6,194	2,916,446	645,612	504,041	208,081	54,624	4,410,109
	TOTALI I AKTIVIT + TOTALI I ZERAVE JASHTË BILANCIT	9,209,336	10,647,862	17,146,683	5,417,600	13,947,523	61,782,885	26,469,321	144,621,210

Kodi	PASIVET SIPAS MATURIMIT TË MBETUR	DITE	MUAJ				VITE		TOTALI
	(në mijë lekë)	Deri 7	7 dite - 1	1 - 3	3 - 6	6 - 12	1 - 5	> 5	
1	VEPRIMET ME INSTITUCIONET FINANCIARE	22,401,235	-	0	-	-	-	-	22,401,235
2	VEPRIME ME KLIENTËT	4,718,853	8,034,751	6,948,335	6,814,316	25,959,364	44,999,657	3,035,150	100,510,426
3	VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	-	-	-	-	-	-	-	-
42	DETYRIME TË TJERA	71,070	255,909	247,770	15,320	1,735,702	93,768	106,073	2,525,612
5	BURIMET E PËRHERSHME	89,798	164,555	475,597	612,604	1,309,635	7,250,854	1,963,712	11,866,753
	Totali i pasivit	27,280,956	8,455,215	7,671,702	7,442,239	29,004,701	52,344,280	5,104,935	137,304,027
	Totali i zerave jashte bilancit	12,269	-	-	-	-	-	-	12,269
	TOTALI I PASIVIT + TOTALI I ZERAVE JASHTË BILANCIT	27,293,224	8,455,215	7,671,702	7,442,239	29,004,701	52,344,280	5,104,935	137,316,295

12. Politikat e shpërblimit

Politika e shpërblimit apo sistemi i bonusit për punonjësit e Bankës Amerikane të Investimeve bazohet në Procesin e Vlerësimit të Performancës. Ky proces ka në fokus të tij performancën sasiore dhe atë cilësore. Për të gjitha pozicionet ku konsiderohet e mundur, aplikohet vlerësimi 360*. Procesi i Vlerësimit të Performancës synon të identifikojë, monitorojë, vlerësojë e shpërblejë përpjekjet dhe rezultatet e cdo punonjësi, gjithashtu edhe të evidentojë e mentorojë në vazhdim potencialet dhe zhvillimin e talentëve. Nëpërmjet indikatorëve të përfshirë në të, ky proces ndikon gjithashtu në ndërtimin e një kulture organizative në bankë, duke e konsideruar këtë të fundit si një element suksesi afatgjatë.

13. Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë

Anëtarët joekzekutivë të Këshillit Drejtues të Bankës, marrin/përfitojnë vetëm një tarifë fikse vjetore për kontributin e tyre dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit Drejtues, tarifë e cila është e njëjtë për secilin prej tyre.

Anëtarët ekzekutivë të Bankës, nuk kanë/përfitojnë asnjë trajtim të vecantë ndryshe nga punonjësit e tjerë të Bankës.

14. Politikat kontabël

14.1. Bazat e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar “Metodologjia e Raportimit dhe Përmbytjes së Raportimit Financiar” të aprovuar nga Banka e Shqipërisë në 24 Dhjetor 2008 dhe kuadrin rregullator dhe kërkesat e Bankës së Shqipërisë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim letrat me vlerë të vlefshme për shitje, të cilat, të cilat janë matur me më të voglën ndërmjet koston dhe vlerës së drejtë. Të dhënat aktuale dhe ato krahasuese janë shprehur në mijë Lekë Shqiptar (“ALL”).

14.2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë periudhën e paraqitur në pasqyrat financiare të Bankës.

(a) Monedha e huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer fillimisht në monedhën funksionale të Bankës me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare perfshi kapitalin në valutë të huaj janë ripërkthyer në monedhën funksionale me kurset e këmbimit në datën e mbylljes së bilancit. Të gjitha diferencat përkatëse njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në valutë të huaj të matura me vlerën e drejtë, janë ripërkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferencat valutore të cilat rezultojnë nga ripërkthimi njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat e huaja kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit në monedhë të huaj janë si më poshtë (në Lekë):

	31-Dhjetor-24	31-Dhjetor-23
1 USD	94.26	93.94
1 EUR	98.15	103.88
1 GBP	118.16	119.47

(b) Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet në arkë, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe aktivet financiare afat shkurtër shumë likuide me maturitet më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjete monetare dhe të ngjashme mbahen në bilanc me koston e amortizuar.

(c) Letrat me vlerë për investime

Të vlefshme për shitje

Letrat me vlerë të vlefshme për shitje janë ato letra me vlerë që Banka i blen me qëllim që ti mbajë për një periudhë më të vogël se gjashtë muaj, me përjashtim të atyre letrave me vlerë që Banka i mban deri në maturim dhe përmbushin rregullat në lidhje me letrat me vlerë për investim. Letrat me vlerë të vlefshme për shitje përfshijnë gjithashtu letrat me vlerë të cilat nuk mund të mbahen si letra me vlerë të tregtueshme dhe as si letra me vlerë për investim.

Letrat me vlerë të investimit të mbajtura për shitje njihen fillimisht me çmimin e blerjes minus kostot e blerjes. Në çdo datë bilanci bëhen provizionet për humbjet e përealizuara të kapitalit të cilat rezultojnë nga diferenca midis vlerës kontabël dhe çmimit të tregut të letrave me vlerë. Fitimet e përealizuara të kapitalit nuk njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit janë ato letra me vlerë të cilat kanë pagesa të përcaktuara fikse si edhe maturitet fiks, për të cilat banka ka si qëllim për ti mbajtur deri në maturitet, duke përfshirë bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të investimit mbahen në koston e amortizuar.

(d) Huatë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët

Huatë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme ose në një kohë të afërt.

Huatë dhe paradhëniet për klientët njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe për rrjedhojë mbahen me vlerën e tyre kontabël, duke zbritur të gjitha humbjet e mundshme nga kreditë.

Huatë fshihen nga bilanci me vendim të Komitetit të Çështjeve të ndjeshme dhe Provizionimit, nëse klienti nuk paguan dhe është në vështirësi serioze për të paguar, ose kur të ardhurat nga kolaterali nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Huatë kontabilizohen në momentin e disbursimit dhe pagesa e kredive kontabilizohet në momentin e arkëtimit, së bashku me komisionin e disbursimit të kredisë i cili mbledhet në momentin e lëvrimin të kredisë.

(e) Provizione për humbjet nga huatë

Politikat për provizionimin e huave janë në përputhje me kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë”. Në bazë të kërkesave përkatëse mbikëqyrëse, Banka klasifikon huatë e akorduara në pesë kategori të rrezikut. Për çdo kategori të rrezikut aplikohen normat e provizionit për humbjet e mundshme të huave vijon si më poshtë:

Klasifikimi	Ditë vonesat për kreditë	Ditë vonesat për overdraftet	Normat e fondit rezervë mbi principalin	Normat e fondit rezervë mbi interesin
Standard	Deri në 30 ditë	Deri në 30 ditë	1%	1%
Në ndjekje	31 në 90 ditë	31 në 60 ditë	5%-10%	5%-10%
Nën-standard	91 në 180 ditë	61 në 90 ditë	20%	100%
Të dyshimta	181 në 365 ditë	91 në 180 ditë	50%	100%
Të humbura	Mbi 365 ditë	Mbi 181 ditë	100%	100%

Strukturat drejtuese të Bankës vendosin për klasifikimin e portofolit të kredisë në një nga kategoritë e sipër-përmendura në bazë të një analize, e cila merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- situatën financiare të huamarrësit;
- situatën financiare të garantuesit;
- cilësinë e kolateralit të siguruar;
- ditët e vonesës;
- lëvizjet në llogarinë e overdraftit të huamarrësit;
- ristrukturimin e huasë si rezultat i përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit.

(f) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për tu rishitur (marrëveshjet e anasjellta të riblerjes) dhe letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për tu riblerë (marrëveshjet për riblerje), në përgjithësi trajtohen si transaksione financiare të garantuara dhe kryhen në formën e parapagimeve ose arkëtimeve plus interesin e përlogaritur. Letrat me vlerë të marra mbi bazën e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes dhe letrat me vlerë të dhëna sipas marrëveshjeve të riblerjes nuk njihen ose hiqen nga bilanci, derisa hiqet dore nga kontrolli i të drejtave kontraktuale të cilat përfshijnë këto letra me vlerë. Interesat e fituara nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve dhe interesi i marrëveshjeve të riblerjeve njihen si të ardhura nga interesi ose shpenzime interesi për secilën marrëveshje, gjatë kohëzgjatjes së çdo marrëveshje. Të gjitha marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta kryhen me Bankën Qendrore të Shqipërisë. Transaksionet e huadhënies dhe huamarrjes së letrave me vlerë në përgjithësi janë të siguruara me letra me vlerë ose mjete monetare. Transferimi i letrave me vlerë kundrejt palëve pasqyrohet në pasqyrën e bilancit nëse transferohen edhe rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Pagesa ose arkëtimi paraprak si kolateral regjistrohet si aktiv ose pasiv.

(g) Aktivet afatgjata materiale

Ndërtesat dhe pajisjet mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi llogaritet sipas metodës lineare me qëllim shpërndarjen e koston së aktiveve afatgjata mbi kohën e parashikuar të shfrytëzimit. Amortizimi llogaritet duke filluar nga muaji në vijim të muajit të blerjes.

Përqindjet e përdorura të amortizimit vjetor janë si më poshtë:

Ndërtesat	2.5%
Mjete transporti	20%
Pajisje zyre	20%
Pajisje Kompjuterike	25%

(h) Aktivet afatgjata jo materiale

Aktivët afatgjata jo materiale mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar. Aktivët afatgjata jo materiale përfaqësojnë programe kompjuterike dhe licenca, të cilat amortizohen duke përdorur metodën e amortizimit linear mbi kohën e parashikuar të shfrytëzimit. Amortizimi llogaritet duke filluar nga muaji në vijim të muajit të blerjes.

(i) Inventari i aktiveve të marra në zotërim

Inventari përfshin aktivet e marra në zotërim nëpërmjet ekzekutimit të garancisë që siguron kreditë me probleme dhe paradhëniet e klientit të cilat Banka nuk planifikon ti japi me qira, ose ti mbajë në përdorim por janë planifikuar të shiten brenda një periudhe të shkurtër të arsyeshme, pa qenë objekt i ristrukturimit të rëndësishëm. Sipas rregullores nr. 62, datë 14.09.2011 "Për menaxhimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e tyre të huaja" i amenduar, fondet rezervë duhet të krijohen brenda një periudhe jo më të gjatë se 7 (shtatë) vjet nga data e marrjes në zotërim të tyre dhe në vlerë jo më pak se norma në përqindje e vlerës kontabël e këtyre aseteve, sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	I	II	III	IV	V	VI	VII
Norma e akumuluar e zhvlerësimit	5%	15%	30%	45%	60%	80%	100%

Për asetet e luajtshme, bankat krijojnë fonde rezervë jo më pak se 100% të vlerës kontabël të asetit të luajtshëm, në rast se ato nuk mund t'i shesin këto asete brenda një viti nga data e tyre të blerjes.

Në përputhje me rregulloren, bankat, për asetet e paluajtshme dhe atyre të luajtshme të marra në zotërim deri më 31 dhjetor 2015, për arsye të llogaritjes të fondeve rezervë, bazuar në direktivat e rregullores, duhet të konsiderojnë vitin 2016 si vitin e parë.

(j) Depozitat dhe borxhi i varur

Depozitat dhe borxhi i varur përbëjnë burimet e financimit të borxhit të bankës. Depozitat dhe borxhet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar nëpërmjet metodës së normës efektive të interesit.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për riblerjen e aktivit (ose të një aktivi të ngjashëm) me çmim fiks në një datë në të ardhme ("repo" ose "stock lending") marrëveshja kontabilizohet si depozitë, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

(k) Provizione për rreziqe dhe shpenzime

Provizioni për rreziqet dhe shpenzimet (ndryshe nga humbjet e kredisë) njihet nëse, si rezultat i një ngjarje në të kaluarën Banka disponon një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri, dhe ka gjasa që të kërkojë dalje të përfitimeve ekonomike për të mbyllur detyrimin.

(l) Interesat

Interesat llogariten në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në bazë të kushteve kontraktore të nënshkruara midis Bankës dhe palëve të treta. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi kontabilizohen sipas metodës së interesit efektiv.

(m) Tarifat dhe Komisionet

Tarifat dhe komisionet për transaksione të ndryshme operacionale amortizohen gjatë gjithë jetëgjatësisë së aktivitetit dhe pasivitetit financiar në fjalë për të cilin realizohet ose shpenzohet. Të ardhura të tjera nga komisionet, përfshirë komisionet e shërbimit, komisionet për menaxhimin e investimeve, komisionet e shitjeve dhe komisionet e depozitave njihen në momentin e kryerjes së shërbimit përkatës.

Shpenzime të tjera për komisionet lidhen kryesisht me komisionet për transaksionet dhe shërbimet, të cilat shpenzohen në momentin e marrjes së shërbimit.

(n) Të ardhura nga këmbimet valutore dhe aktivitete të tjera bankare

Këto të ardhura përfshijnë fitimet neto nga veprimet e këmbimeve valutore si dhe fitimin dhe humbjet nga rivlerësimi valutues i mjeteve dhe detyrimeve.

(o) Shpenzimet e punonjësve

Banka operon vetëm me kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që sigurojnë përfitime pensioni për personelin në momentin e daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të siguruar minimumin e nivelit të pensionit sipas ligjit për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar kontributi për pensionin. Kontributet e Bankës ndaj përfitimeve të planit të pensionit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(p) Qiraja dhe përmirësimet në mjediset e marra me qira

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira ose përmban një qira, bazohet në përmbajtjen e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve të caktuara dhe marrëveshja njihet të drejtën për të përdorur aktivin.

Banka ka vetëm marrëveshje qiraje operative, pagesat e të cilave njihen në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë. Kostot e rikonstruksioneve të kryera në këto ambiente që përdoren në bazë të këtyre marrëveshjeve kontabilizohen si aktivet e tjera dhe amortizohen gjatë kohëzgjatjes së qirasë në mënyrë lineare.

Pagesat e qirasë së rastit kontabilizohen duke rishikuar pagesat minimale të qirasë gjatë periudhës së mbetur të qirasë në momentin e konfirmimit të rregullimit të qirasë.

(q) Tatimi mbi fitimin

Banka përcakton tatimin në fund të periudhës në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Tatimi mbi fitimin llogaritet nëpërmjet rregullimit të rezultatit financiar sipas SNRF me zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara në legjislacionin shqiptar si të patatueshme/të pazbatueshme.

(r) Transaksionet jashtë bilancit

Transaksionet jashtë bilancit përfaqësojnë marrëveshjet midis bankave dhe palëve të tjera. Këto marrëveshje përfaqësojnë të drejtat dhe angazhimet të cilat ka mundësi të sjellin një aktiv ose detyrim në zbatim të kushteve kontraktuale. Njohja ndodh në momentin e nënshkrimit të kontratës. Për angazhime të caktuara, krijohet një fond rezervë për të mbuluar rrezikun e mundshëm të kredisë. Moshnjohja ndodh nëse aktivi ose detyrimi përkatës realizohet në datën e mbarimit/maturimit të kontratës.

(s) Transaksione valutore

Kontratat e kursit të këmbimit janë marrëveshje për shkëmbimin e vlerave të caktuara të monedhave me një kurs këmbimi në datën e blerjes ose shitjes. Vlera nominale e këtyre kontratave nuk përfaqëson rrezikun aktual të tregut ose kredisë të lidhur me këtë produkt.